VENDIM
Nr. 353, datë 11.5.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 83, DATË 3.2.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË KRIJIMIT TË NJËSIVE TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 26, të ligjit nr. 114/2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 4 e vendimit nr. 83, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

"4. Njësitë publike që krijojnë njësinë e auditimit të brendshëm, sipas pikës 1 të këtij vendimi, nuk programojnë të kryejnë shërbimin e auditimit të brendshëm për njësitë e varësisë, të cilat kanë në strukturën e tyre organizative njësi të auditimit të brendshëm. Ky shërbim në njësitë e varësisë mund të kryhet në raste të veçanta me urdhër të titullarit të njësisë publike të organit epror.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama